KLINIKA STOMATOLOGJIKE UNIVERSITARE

NJOFTIM PËR VEND VAKANT

Specialist/-e i/e Shërbimeve Mbështetëse

Lënda: Shpallje e njoftimit për vendin vakant: Specialist/-e i/e Shërbimeve Mbështetëse

Drejtuar: Agjencisë së Prokurimit Publik

Në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; VKM-së nr. 176, datë 29.03.2006, “Për botimin e Buletinit të Njoftimeve Publike”; Urdhrit nr. 624, datë 05.12.2024, “Për miratimin e organikës së Klinikës Stomatologjike Universitare”, si dhe për nevojat e institucionit, kërkojmë njoftimin për vendin e lirë të punës si më poshtë:

1. Pozicioni vakant

Klinika Stomatologjike Universitare njofton shpalljen e 1 (një) vendi vakant në pozicionin Specialist/-e i/e Shërbimeve Mbështetëse.

2. Kriteret e përgjithshme

1. Të jetë shtetas shqiptar.
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën (të vërtetuara me raport mjekësor).
4. Të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo vepre penale me dashje.
5. Të mos ketë ndaj tij/saj masë disiplinore në fuqi për largim nga puna në institucione të tjera publike.

3. Arsimi dhe kualifikimet

- Arsimi: Të zotërojë diplomë të ciklit të dytë (Master i Shkencave / Master Profesional / Arsim i Lartë) në shkenca ekonomike.
- Gjuhë e huaj: Dëshmi e njohjes së një gjuhe të huaj (e mbrojtur në IAL publike ose me testim ndërkombëtar).
- Njohuri shumë të mira të paketës Microsoft Office, veçanërisht Word dhe Excel.
- Eksperiencë pune: 1–3 vjet në fusha të ngjashme.

4. Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen në intervistë

Kandidatët do të testohen në lidhje me njohuritë mbi aktet ligjore dhe nënligjore të mëposhtme:

- Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar.
- Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar.
- Legjislacioni për prokurimin publik.

5. Dokumentacioni i kërkuar

1. Kërkesë me shkrim / letër motivimi.
2. Jetëshkrim (CV) i përditësuar.
3. Diploma e shkollës së lartë dhe lista e notave / fotokopje të njësuara me origjinalin. Diplomat dhe dokumentacioni i marrë jashtë vendit duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave.
4. Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj.
5. Fotokopje e librezës së punës.
6. Fotokopje e letërnjoftimit (ID-së).
7. Raport mjekësor për aftësinë në punë / vërtetim i gjendjes shëndetësore.

8 Dëshmi penaliteti.

9 Çdo dokumentacion tjetër shtesë që vërteton arsimimin shtesë, trajnimet, vlerësimet dhe referencat e mundshme, si dhe faktet e tjera të përmendura nga aplikanti në jetëshkrim.

10 Të paktën një letër reference.

6. Mënyra e vlerësimit

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet nëpërmjet konkurrimit me dosje dhe intervistave të drejtpërdrejta. Në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar, kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën. Në intervistën e punës, kandidatët do të vlerësohen për njohuritë mbi legjislacionin e sipërcituar, aftësitë, kompetencat, eksperiencën e mëparshme, motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë për karrierën.

7. Dorëzimi i dokumentacionit

1 Një listë përmbledhëse e të gjitha dokumenteve që dorëzohen duhet të jetë e nënshkruar rregullisht nga kandidati.

2 Të gjitha dokumentet duhet të jenë të noterizuara brenda 6 (gjashtë) muajve të fundit.

3 Dokumentet mund të jenë origjinale ose fotokopje të noterizuara.

4 Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyera dhe të njësuara sipas ligjit.

5 Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikimin e kandidatit.

6 Dokumentet dorëzohen pranë Zyrës së Protokollit të KSU-së, në adresën: Rr. Dibra, QSUNT, Tiranë.

7 Afati i dorëzimit: 7 (shtatë) ditë kalendarike nga dita e njoftimit.

KLINIKA STOMATOLOGJIKE UNIVERSITARE